



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 86/2018

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIN
E PAGAVE TË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, si dhe të nenit 37, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

II. Struktura e organizative e KDIMDHP-së është sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës së KDIMDHP-së është sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. Vendimi i Kuvendit nr. 106/2014 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", shfuqizohet.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz RUCI

Miratuar në datën 19.7.2018

